

Faza II

ARRITJET KRYESORE

2019-2023

Arritjet Kryesore

Faza II

2019-2023

Projekti Shëndet për të Gjithë (HAP)



Rr. Themistokli Gërmenji, Pallati Helios,
Kati i dytë, Tiranë, Shqipëri



www.hap.org.al



info@hap.org.al



[HAP.Albania](https://www.facebook.com/HAP.Albania)



[Health.For.All.Project](https://www.instagram.com/Health.For.All.Project)



[Health-For-All-Project-HAP](https://www.linkedin.com/company/Health-For-All-Project-HAP)



TABELA E PËRMBAJTJES

01. Faktet Kryesore	4
02. Konteksti i Projektit	6
03. Rezultatet Kryesore të Fazës së Parë	8
04. 2019-2023 - Arritjet e Fazës së Dytë	10
Mbështetja për Hartimin e Politikave dhe Strategjive të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri	11
Profilet e Përditësuara të Punës së Personelit të Kujdesit Shëndetësor Parësor	12
Programi i Ri i Masterit në Infermieri Familjare	13
Programi i Masterit në Menaxhim Shëndetësor	15
Përmirësimi i Kapaciteteve të Operatorit të Shërbimeve Shëndetësore	16
Fuqizimi i Kapaciteteve Kërkimore Operacionale në Sistemin dhe Shërbimet Shëndetësore	17
Përmirësimi i Cilësisë së Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor	19
Modelet e Reja të Shërbimeve për Kujdesin Shëndetësor në Banesë	21
Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor i Personelit Të KSHP-së	22
Bashkëpunimi Mes Palëve Vendore të Interesit	23
Mbështetja për Shërbimet Shëndetësore Gjatë COVID-19	25
05. Objektivat e Fazës së Konsolidimit	26
06. Shkurtesa	28



01. FAKTET KRYESORE

EMRI I PROJEKTIT

Shëndet për të Gjithë (HAP)

SFERA E VEPRIMIT

Kujdesi Shëndetësor Parësor

FAZAT

Projekt me Tri Faza: 2015-2019 | 2019-2023 | 2023-2026

OBJEKTIVAT E FAZËS SË DYTË

Popullsia shqiptare përfiton shëndet më të mirë falë shërbimeve të përmirësuara të kujdesit shëndetësor parësor.

Rezultati 1: MShMS-ja dhe strukturat e saj rajonale menaxhojnë me efektshmëri dhe eficiencë më të lartë shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor.

Rezultati 2: Qytetarët në qarqet e synuara kanë akses dhe përdorin me efektshmëri shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor të një cilësie më të mirë.

KUADRI KOHOR

Prill 2019 – Mars 2023

QARQET E VEPRIMIT TË PROJEKTIT

Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Shkodër, Dibër

DONATORI

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

ZBATUESI

Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale

PARTNERËT

Kombëtarë

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe strukturat e saj të varësisë
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Fakulteti i Ekonomisë
- Njësitë e Qeverisjes Vendore
- OJQ vendore

Ndërkombëtarë

- Organizata Botërore e Shëndetësisë
- Banka Botërore përmes Projektit “Përmirësimi i Sistemeve Shëndetësore”



Përdorimi i Pajisjeve Mjekësore
në Kunder të Vizitës Mjekësore

02. KONTEKSTI I PROJEKTIT



Projekti Shëndet për të Gjithë (HAP) është një projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim që po zbatohet në Shqipëri që nga viti 2015 me qëllim përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor për popullsinë shqiptare në përgjithësi dhe për grupet e cënueshme në veçanti.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka shënuar zhvillime të ndjeshme si pasojë e rritjes ekonomike në vend. Por në të njëjtën kohë, sektori i shëndetësisë përballet me një sërë sfidash. Ndryshimet demografike dhe barra në rritje e Sëmundjeve Jo të Transmetueshme (SJT), si diabeti apo hipertensioni, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur. Ndërkohë, një pjesë e mirë e popullsisë, kryesisht ata që banojnë në zonat rurale, ka akses të kufizuar ndaj shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (KShP) për shkak të cilësisë së ulët të kujdesit, numrit të ulët të personelit mjekësor dhe, në raste të caktuara, vështirësive financiare. Kujdesi në banesë është ende embrional, ndërsa roli i infermierit në trajtimin e SJT-ve nuk është i përcaktuar qartë. Këto tendenca përkeqësohen edhe më tej nga migrimi në shkallë të lartë i personelit shëndetësor nga zonat rurale drejt atyre urbane, si dhe nga emigrimi nga Shqipëria drejt Evropës Perëndimore, çka ka rezultuar në mbulim të pamjaftueshëm të kujdesit shëndetësor për popullsinë dhe në pabarazi gjeografike në shpërndarjen e fuqisë punëtore shëndetësore.

Gjatë Fazës së Parë (2015-2019), HAP ka dhënë kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të popullsisë ndaj shërbimeve shëndetësore në qarqet e Dibrës dhe Fierit duke ndikuar ndjeshëm në kënaqshmërinë e pacientëve ndaj këtyre shërbimeve. Projekti ka mbështetur në vazhdimësi aftësimin e ekipeve menaxheriale të qendrave shëndetësore përmes trajnimeve e programeve të vazhdueshme si dhe vizitave studimore jashtë vendit. Krahës tyre, investimet e mëdha që janë bërë në rehabilitimin e infrastrukturës dhe në pajisjen e ekipeve të mjekësisë familjare me mjetet e nevojshme mjekësore kanë bërë që popullsia e dy qarqeve të ndërhyrjes së Projektit të gëzojë cilësi më të lartë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor.

Gjatë Fazës së Dytë (2019-2023) HAP vijoi bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe palët e tjera të interesit për shtrirjen e ndërhyrjeve të Projektit në gjashtë qarqe të tjera: Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Korçë, Shkodër. HAP mbështeti hartimin e dokumenteve të rëndësishme strategjike me në fokus zhvillimin e KShP-së në Shqipëri duke përfshirë aspekte të rëndësishme të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe të reformës në shëndetësi. Programet e reja studimore, edukimi mjekësor i vazhdueshëm për ekipin familjar, profilet e përditësuara dhe të reja të punës në KShP, si edhe prezantimi i shërbimeve të reja si ai i kujdesit shëndetësor në banesë ishin një pjesë e rëndësishme e kontributit të Projektit për rritjen e cilësisë së shërbimit që ofrohet në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor në vend.



**03. REZULTATET KRYESORE
TË FAZËS SË PARË**



IMPAKTI MBI CILËSINË E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR DHE AKSESIN NDAJ SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

- 20-30% rritje në cilësinë e kujdesit shëndetësor në Dibër dhe Fier pasi mjekët përmirësuan zbatimin e procedurave dhe protokolleve të standardizuara për kontrollin e SJT-ve.
- 89-95% pacientë të kënaqur ose shumë të kënaqur nga shërbimet shëndetësore në të dyja qarqet.



MBËSHTETJA PËR POLITIKAT DHE STRATEGJITË NË NIVEL KOMBËTAR DHE RAJONAL

- HAP kontribuoi në hartimin dhe shpërndarjen e Planit të Veprimit të Promocionit Shëndetësor 2017-2021.
- HAP ofroi mbështetje teknike për hartimin e Strategjisë Kombëtare për reformimin e KShP-së në Shqipëri, një nismë e MShMS-së.



FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË EKIPEVE MENAXHERIALE TË KSHP-SË DHE MË TEJ

- 80 menaxherë të qendrave shëndetësore dhe 97 kryeinfermiere morën pjesë në modulet e trajnimit menaxherial mbi legjislacionin shqiptar, menaxhimin e burimeve njerëzore, lidhshin, komunikimin etj.
- 80 menaxherë dhe ofrues të kujdesit shëndetësor parësor morën pjesë në vizita studimore jashtë vendit lidhur me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të KShP-së.
- Për herë të parë, u hap një program i ri masteri në Menaxhim Shëndetësor i cili po ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës.



PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE KLINIKE TË EKIPEVE TË KSHP-SË

Grupet e Kolegëve, si një model novator për Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor, iu prezantuan ekipeve të mjekësisë familjare në Dibër dhe Fier, duke sjellë një përmirësim përkatesisht prej 20% dhe 22% në këshillimin e pacientëve me diabet dhe hipertension nga mjekët e familjes.



PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHËNDETËSORE TË KSHP-SË DHE FURNIZIMI ME PAJISJE MJEKËSORE

- 316.150 banorë po përfitojnë shërbim të përmirësuar shëndetësor falë rehabilitimit të 17 qendrave shëndetësore dhe një poliklinike specialitetesh (5 në Dibër; 10 në Fier; 2 në Tiranë).
- 223 mjekë familjeje janë pajisur me çantën e mjekut dhe janë trajnuar për përdorimin e 17 mjeteve mjekësore.
- 1,181 infermiere familjeje janë pajisur me çantën e infermieres që përmban 16 instrumente mjekësore bazë dhe janë trajnuar për përdorimin e tyre.



MBËSHTETJA E QEVERISJES SË MIRË DHE LLOGARIDHËNIES NË KSHP

- në 6 Drejtori të Shëndetit Publik janë ngritur njësi të anti-korrupsionit.
- 6.465 anëtarë komuniteti kanë marrë pjesë në 182 seanca të informimit publik të organizuara për të ndërgjegjësuar komunitetin mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientëve dhe mbi nismat e MShMS-së dhe institucioneve të tjera të shëndetit.

Activities for Year 1 April 2019 – 31 March 2020
Summary of activities

Review of PHC and
services in Albania is
a new approach to
national sector and
PHC Strategy in
CHH in Albania



MHP

Ministry of Health

04. 2019-2023
ARRITJET E
FAZËS SË DYTË

MBËSHTETJA PËR HARTIMIN E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHQIPËRI

HAP mbështeti hartimin, miratimin dhe zbatimin e **Strategjisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor 2021-2025**, i miratuar nga Këshilli i Ministrave më 20 maj, 2020. HAP kontribuoi në:

- hartimin dhe pilotimin e modeleve të reja të kujdesit në banesë për pacientë të invalidizuar dhe të moshuar;
- rishikimin dhe hartimin e profileve të përditësuara të nevojshme për shërbime të qëndrueshme të KShP-së;
- përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes hartimit dhe mbështetjes për zbatimin e udhëzuesve dhe protokolleve klinike për trajtimin e SJT-ve;
- hartimin dhe shpërndarjen e "Udhëzuesit për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KShP" dhe manualit "Kujdesi mjekësor për të moshuarit në KShP";
- hartimin dhe shpërndarjen e "Manualit të procedurave standarde të auditimit klinik";

Projekti ka kontribuar në fushën e **Burimeve Njerëzore në Shëndetësi** (BNJSH) përmes:

- hartimit të vlerësimit të situatës së BNJSH-së në Shqipëri, përgatitur me mbështetjen teknike të HAP dhe miratuar nga MShMS në fillim të vitit 2020;
- studimit mbi "modelet e alokimit të kohës së punës në nivelin e Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri", i përfunduar në shtator të vitit 2020;
- hartimit dhe miratimit të profileve dhe përshkrimeve të reja dhe të përditësuara të punës për të gjitha kategoritë e personelit të KShP-së;
- disa studimeve specifike mbi kënaqësinë e personelit të KShP-së në zona urbane dhe rurale të Shqipërisë, të publikuara në faqen e internetit të HAP në formën e relacioneve teknike/mbi politikat.

Organizimi i ri i qendrave shëndetësore i miratuar nga MShMS



**Qendra
Shëndetësore Bazë**



**Qendra Socio-
Shëndetësore**



**Qendra
Shëndetësore 24/7**



**Qendra
Shëndetësore të
Specializuara**

HAP do të vijojë mbështetjen për zbatimin e kësaj ndarjeje të re të qendrave shëndetësore.

PROFILET E PËRDITËSUARA TË PUNËS SË PERSONELIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR

HAP rihartoi një paketë prej 10 profilesh/përshkrimesh pune duke përfshirë profesionet kryesore të fuqisë punëtore të KShP-së. Paketa përfshin profilet e mëposhtme:



**Menaxher
i Qendrës
Shëndetësore**



**Mjek
Familjeje**



Kryeinfermiere



**Punonjës
Social**



Fizioterapist



**Infermiere
për Edukimin
Shëndetësor dhe
Check-up**



**Infermiere
Shkolle**



**Infermiere
Familjeje**




**Infermiere
e Familjes/
Komunitetit**



**Infermiere
e Kujdesit
Shëndetësor në
Banesë**

HAP ka mbështetur krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e profileve të reja të infermiereve në tri drejtime:



Infermieret e qendrave shëndetësore të përzgjedhura janë trajnuar për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë që përcaktohen në profilet e reja dhe të përditësuara.

249 INFERMIERE

75 TRAJNIME

21 QENDRA
SHËNDETËSORE

1350 ORË
TRAJNIMI

PROGRAMI I RI I MASTERIT NË INFERMIERI FAMILJARE

HAP ka mbështetur zhvillimin e një programi të ri të Masterit në Infermieri Familjare, në përgjigje të një kërkesë formale nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Shkencave Teknike. Për të ndihmuar grupin e punës u mobilizua ekspertizë ndërkombëtare dhe lokale me mbështetjen e të cilëve u hartua dhe u miratua kurrikulumi i ri. Ndërkaq, 27 studentë kanë marrë pjesë në programin e masterit në dy vitet akademike, 2021-2022 dhe 2022-2023.



Përmirësimi i Aftësive Pedagogjike

HAP ka mundësuar ofrimin e një cilësie më të lartë mësimdhënieje përmes trajnimeve të reja mbi aftësitë pedagogjike dhe klinike në laboratorin e simulimit si dhe përmes stazhit praktik në vendin e punës, duke investuar në këtë mënyrë në një brez të ri infermieresh me aftësi të avancuara. Trajnimet e mbështetura nga HAP janë ofruar për lektorë të Fakultetit të Mjekësisë dhe Shkencave Teknike, për profesorët e Masterit, supervizorët e praktikës klinike dhe për personelin e laboratorit të simulimit klinik, në formën e trajnimeve të posaçme, programeve online apo si shkëmbim përvojash me Universitetin e Bazelit në Zvicër dhe atë të Leuvenit në Belgjikë.



Përmirësimi i Infrastrukturës së Mësimdhënies

HAP përmirësoi infrastrukturën fizike të laboratorit të ri të praktikës klinike në Fakultetin e Mjekësisë dhe Shkencave Teknike. Laboratori u furnizua me pajisje dhe materiale më moderne për mësimdhënien si edhe u hartuan udhëzues për menaxhimin e tij dhe një seri manualesh për operimin e çdo pajisjeje gjatë procesit të mësimit. Gjithashtu, u rinovua plotësisht një klasë IT me mobiljet dhe pajisjet e nevojshme teknologjike.



Përmirësimi i Infrastrukturës të Stazhit Klinik

HAP furnizoi me pajisje mjekësore dhe infermierore 10 qendra shëndetësore urbane në Tiranë, ku kryejnë praktikën klinike studentët e programit të Masterit. Kështu, 295 mjekë dhe 345 infermiere që operojnë në këto ambiente janë pajisur dhe trajnuar për përdorimin e këtyre pajisjeve të reja.



PROGRAMI I MASTERIT NË MENAXHIM SHËNDETËSOR

Programi i Masterit në Menaxhim Shëndetësor është ofruar për gjashtë vite rresht që nga viti 2017. Nga 173 studentët e regjistruar zyrtarisht, 99 studentë u diplomuan me sukses deri në vitin 2022.



Përmirësimi i Përbajtjes së Programit të Masterit në Menaxhim Shëndetësor

Në vitin 2020 u bë një vlerësim i jashtëm i Masterit në Menaxhim Shëndetësor dhe u dhanë një sërë rekomandimesh. Në vijim të këtij vlerësimi të realizuar me mbështetjen e HAP, Fakulteti i Mjekësisë dhe ai i Ekonomisë zbatuan rekomandimet më të rëndësishme me synim përmirësimin e cilësisë së programit dhe përshtatjen e tij më të mirë kontekstin e shërbimeve shëndetësore.



Mbështetja për Infrastrukturën e Mësimdhënies

HAP ka mbështetur përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, i cili ndan përgjegjësinë për programin e Masterit. Një klasë e këtij departamenti u furnizua me pajisje IT, tavolina dhe karrige për studentët, si dhe kompjutera dhe projektorë sipas nevojës.



Mbështetja për Studentët e Masterit

HAP ka mbështetur pedagogët e dy fakulteteve që nga fillimi i programit të Menaxhimit Shëndetësor për të përgatitur libra mësimorë dhe përmbledhje në gjuhën shqipe, të cilat më pas u shtypën dhe u shpërndanë falas për 164 studentët e Masterit. Që nga fillimi i programit, çdo student i Masterit ka marrë një set prej 14 manualësh për modulet përkatëse. Po ashtu, katër studentë janë mbështetur financiarisht dhe teknikisht për të kryer një disertacion në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shërbimeve shëndetësore që bashkëveprojnë me HAP.

○ **33%**

e të diplomuarve janë
ngritur në detyrë pas
diplomimit

○ **52%**

e të diplomuarve
mbajnë poste
menaxheriale

○ **79%**

e të diplomuarve
deklarojnë se ky master
i ndihmoi të ishin më
të aftë në punën e
përditshme

PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE TË OPERATORIT TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

HAP ka mbështetur hartimin e Planit Strategjik të Drejtorisë Qendrore të Operatorit (DQO) që drejton zhvillimin organizativ, si dhe vendimet, veprimet dhe aktivitetet e tij.

Mbështetje për Fuqizimin e Kapaciteteve të Personelit të Operatorit

14



pjesëmarrës

nga katër Drejtorinë Rajonale dhe DQO-ja morën pjesë në një kurs trajnimi gjashtëditor që i ndihmoi të krijonin formularë të standardizuar për mbledhjen e indikatorëve specifikë në nivelin e qendrave shëndetësore.

24



drejtorë

të qendrave të KShP-së, të shëndetit publik dhe shërbimeve statistikore nga katër zyrat e Drejtorive Rajonale të Operatorit kanë marrë pjesë në një trajnim për standardizimin e formularëve të raportimit të indikatorëve shëndetësorë.

6



profesionistë

nga Drejtoria Rajonale e Operatorit në Vlorë morën pjesë në kurset e Shkollës Verore të Luganos në vitin 2021.

Mbështetje për Shtrirjen e Shërbimeve të reja të KShP-së

40



profesionistë

nga NjVKSH-të dhe qendrat shëndetësore në Durrës, Elbasan, Korçë dhe Shkodër kanë marrë pjesë në 5 vizita në terren në qendrat shëndetësore të Fierit, të cilat po zbatojnë kujdesin në banesë, protokollet e SJT-ve dhe sistemin e planifikimit të vizitave.

FUQIZIMI I KAPACITETEVE KËRKIMORE

OPERACIONALE NË SISTEMIN DHE SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Mbështetja e HAP në fuqizimin e kapaciteteve kërkimore në sistemin dhe shërbimet shëndetësore ka kontribuar në nxitjen e mendimit kritik dhe reflektimit mbi operacionet e sistemit shëndetësor në Shqipëri, duke rezultuar në shërbime shëndetësore efektive dhe efikase me në qendër pacientin.

Trajnimi mbi metodat dhe praktikat kërkimore

67

studentë, hulumtues të rinj dhe personel akademik kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit në kërkimin operacional në shëndetësi.

Mbështetje për kërkime operationale

10

mikro-grante u janë ofruar hulumtuesve të suksesshëm në fund të një konkursi të hapur për të fuqizuar kapacitetet kërkimore në fushën e shëndetësisë.

Mbështetje për informacion të bazuar në evidenca

4

studime dhe sondazhe vlerësimi para dhe pas ndërhyrjes janë mbështetur nga HAP lidhur me cilësinë e jetës, cilësinë e kujdesit, aksesin ndaj KShP-së, modelet e alokimit të kohës së punës në KShP, dhe mbështetjen për mbledhjen e të dhënave mbi kënaqësinë e pacientit.

Prezantimi i evidencave në konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare

3

3 kanë qenë aktivitetet e rëndësishme shkencore ku HAP ka kontribuar: Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik në Shqipëri (2021), Konferenca Ndërkombëtare e Infermierisë në Shqipëri (2022), dhe Kongresi i Shëndetësisë (2023).

Rritja e kapaciteteve të Komitetit të Etikës për hulumtime shëndetësore

HAP ofroi mbështetje teknike për rishikimin e kuadrit rregullator lidhur me funksionimin e Komitetit të Etikës në Universitetin e Mjekësisë.



PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR

Përpijekjet e vazhdueshme të HAP kanë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e kujdesit të ofruar në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor. Ja disa arritje të rëndësishme:

• Hartimi dhe miratimi i udhëzuesve dhe protokolleve klinike

Mars, 2022 MShMS miraton udhëzuesit dhe protokollet klinike për diabetin, hipertensionin, astmën, SPOK-un, dhe dislipideminë, dhe manualin “Kujdesi mjekësor për të moshuarit në KShP”. Protokollet dhe udhëzuesit u hartuan me mbështetjen e projektit HAP.

Korrik, 2022 MShMS miraton “Udhëzuesin për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KShP”, të hartuar me mbështetjen e projektit HAP.

• Mbështetja për zbatimin e udhëzuesve dhe protokolleve të miratuara

80 qendra shëndetësore në Dibër dhe Fier realizuan trajnime për trajnerë pesëditore për mjekët dhe infermieret e familjes lidhur me zbatimin e udhëzuesve dhe protokolleve të reja.

77 Grupe Kolegësh, me pjesëmarrjen e **319 mjekëve** dhe **1,210 infermiereve të familjes**, u krijuan për të përcjellë njohuritë tek pjesa tjetër e ekipit mjekësor.

• Zbatimi i sistemit të planifikimit të vizitave në Patos dhe Klos

36 MIJË banorë të qendrave shëndetësore në Patos dhe Klos përfitojnë nga sistemi i planifikimit të vizitave, hartimi dhe zbatimi i të cilit u realizua me mbështetjen e HAP.

• Përmirësimi i cilësisë për akreditimin e QSH-ve

31 ekipe të cilësisë u ngritën me mbështetjen e HAP për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe për të përmbushur standardet e akreditimit të Agjencisë së Cilësisë.

30 qendra shëndetësore në qarqet Fier dhe Dibër u akredituan në dhjetor 2022.



MODELET E REJA TË SHËRBIMEVE PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË BANESË

Në fillim të Fazës së Dytë, HAP mobilizoi ekspertizë teknike kombëtare dhe rajonale për të zhvilluar modele të mundshme të Kujdesit Shëndetësor në Banesë (KSHB) për pacientë të invalidizuar si pasojë e sëmundjeve kronike dhe të moshuar që jetojnë vetëm. Ja një kronologji e zhvillimeve:



Pilotimi, zbatimi, monitorimi & vlerësimi, dhe shtrirja e KSHB-së

Trajnimi

92 infermiere nga qarqet pilot Dibër dhe Fier u trajnuan intensivisht.

9 Maj 2021

Infermieret e 9 QSH-ve pilot filluan të ofrojnë kujdes shëndetësor në banesë.

U hartua dhe u miratua një **Plan Monitorimi & Vlerësimi** për shërbimet e kujdesit në banesë si edhe një vlerësim para ndërhyrjes për të identifikuar “Cilësinë e jetës dhe aksesit ndaj shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në Banesë”.

Dhjetor 2021

U miratuan nga MShMS modelet pilot që u propozuan për KSHB-në.

22

qendra të reja shëndetësore dhe 5 qarqe të reja u propozuan nga MShMS për t'u përfshirë në Kujdesin Shëndetësor në Banesë. Këta pacientë filluan të merrnin vizita në banesë në shkurt të vitit 2023.

275

infermiere dhe **19 specialistë** nga NjVKSH-të e qarqeve të reja u trajnuan për aftësi/procedura klinike infermierore të avancuara.

907

pacientë u regjistruan si përfitues të ardhshëm të shërbimeve të kujdesit në banesë.

317

nga 907 pacientët e identifikuar morën 748 vizita në banesë deri në mars 2023.



Furnizimi me pajisje mjekësore, paramjekësore, dhe IT

31 qendra shëndetësore janë furnizuar me pajisjet e nevojshme mjekësore dhe paramjekësore për një zbatim më të mirë të shërbimeve të kujdesit në banesë.

31 koordinatorë të kujdesit në banesë janë mbështetur me laptopë dhe pajisje të nevojshme mësimdhënieje për të lehtësuar aktivitetet e edukimit në vazhdim dhe të Grupeve të Kolegëve.

EDUKIMI I VAZH DUESHËM MJEKËSOR I PERSONELIT TË KSH P-SË

HAP ka zgjeruar me sukses nismat e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor përtej dy qarqeve fillestare përmes përdorimit të Grupeve të Kolegëve, të cilët luajnë një rol thelbësor në avancimin e edukimit dhe shërbimit shëndetësor në të gjitha qarqet që mbulon projekti.

Shtrirja e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor

HAP ka ofruar mbështetje për zgjerimin e Grupit të Kolegëve si një mjet për edukimin në vazhdim për ofruesit e kujdesit parësor përtej dy rajoneve fillestare. Në këtë kuadër, u hartua dhe u shpërnda udhëzuesi “Grupet e Kolegëve – Formë e Edukimit në Vazhdim të Profesionistëve të Shëndetësisë – Një udhëzues për të mbështetur ngritjen dhe funksionimin e tyre” në format elektronik dhe të printuar.

Përdorimi i Grupeve të Kolegëve

Grupet e Kolegëve (GK) aktualisht përdoren gjerësisht për zbatimin e protokolleve të Sëmundjeve Jo të Transmetueshme (SJT), shërbimet e reja të kujdesit në banesë, zbatimin e profileve të reja të infermiereve në qendra shëndetësore dhe ambulanca, përmirësimin e cilësisë për akreditimin e qendrave shëndetësore, kujdesin shëndetësor për pacientët e moshuar, dhe të tjera.

Hartimi i Materialeve Edukative

HAP ka hartuar dhe ka shpërndarë gjerësisht protokollat dhe udhëzuesit klinikë për menaxhimin e SJT-ve, manualin për kujdesin shëndetësor të të moshuarve në KShP, manualin e procedurave të standardizuara infermirore në KShP etj., të cilat janë shumë të dobishme në aktivitetet e Grupeve të Kolegëve.

Trajnime

4,249 pjesëmarrës morën pjesë në aktivitete të Edukimit në Vazhdim (EV) të organizuara në kuadër të objektivave të HAP: a) **2,192 pjesëmarrës** morën pjesë në trajnime të mbështetura nga HAP, duke përbushur një total prej 53,126 orësh trajnimi. b) **2,057 pjesëmarrës** morën pjesë në 196 Grupe Kolegësh, duke përbushur një total prej **40,050 orësh** trajnimi.



Numri total i profesionistëve që kanë marrë pjesë në Grupe Kolegësh:



487 **1523**
VITI I VITI IV

BASHKËPUNIMI MES PALËVE VENDORE TË INTERESIT

Plani i HAP për rindërtimin e infrastrukturës në bashkëpunim me bashkitë dhe autoritetet lokale të shëndetit, si dhe investimet infrastrukturore që pasuan, kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e mbulimit të popullsisë me shërbimet e nevojshme dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor në komunitetet përkatëse.




Mekanizmi i bashkëfinancimit

HAP nënshkroi marrëveshje për bashkëfinancim me 5 bashki për rehabilitimin e godinave shëndetësore. Ndarja e fondeve të investimit ndërmjet HAP dhe autoriteteve lokale ishte përkatësisht 70% me 30%.



Zbatimi i punimeve rehabilituese

Gjatë Vitit 3 dhe 4, u rindërtuan 12 godina shëndetësore (qendra shëndetësore dhe ambulanca) nga bashkitë në bashkëpunim të ngushtë me HAP.



Rindërtimi i qendrave të reja shëndetësore

3 godina shëndetësore - në Ishëm, Borizanë dhe Zall Mner – u rindërtuan nga themelet. Dy prej tyre u mobiluan dhe u furnizuan me pajisjet e nevojshme dhe kanë filluar të ofrojnë shërbime që nga janari i vitit 2022. Punimet në godinën e tretë në Zall Mner përfunduan në mars të vitit 2023.



48,300
banorë

marrin shërbime shëndetësore
në godinat shëndetësore të
rehabilituara / rindërtuara.



MBËSHTETJA PËR SHËRBIMET SHËNDETËSORE GJATË COVID-19

Në përgjigje të nevojave urgjente që lindën nga pandemia e COVID-19, qasja shumëplanëshe e HAP si edhe nisma për bashkëpunime të rëndësishme ndikuan ndjeshëm në nivelin e gatishmërisë dhe të kapaciteteve të ofruesve të kujdesit shëndetësor, duke bërë të mundur një shërbim shëndetësor më efektiv.

Mbështetje për Blerjen e Ventilatorëve

17 ventilatorët që HAP mundësoi për spitalet që trajtonin Covid kanë kontribuar në shpëtimin e jetës së shumë pacientëve gjatë ditëve të errëta të pandemisë.



Furnizimi me Pajisje të Mbrojtjes Personale

640 ofrues të kujdesit shëndetësor parësor në 11 qendra shëndetësore në Tiranë dhe Vorë u furnizuan me pajisje të mbrojtjes personale, puls-oksimetra dhe pajisje të tjera mjekësore, të cilat ndihmuan që ekipi mjekësor të ndihej më i mbrojtur dhe më i përgatitur gjatë ofrimit të shërbimit.



Koncentruesit e Transportueshëm të Oksigjenit

796,700 banorë në Tiranë, Fier dhe Dibër kanë përfituar shërbim shëndetësor më cilësor falë furnizimit të qendrave shëndetësore me pajisjet e nevojshme dhe 58 koncentruesve të oksigjenit të shpërndarë nga HAP në 23 qendra shëndetësore të këtyre qarqeve.



Trajnimi i Ekipit Mjekësor

55 ofrues të kujdesit shëndetësor janë trajnuar për përdorimin e koncentruesve të oksigjenit dhe për të udhëzuar pacientët në shtëpi për përdorimin e tyre.





**05. OBJEKTIVAT E
FAZËS SË KONSOLIDIMIT**

01

Hartimi dhe detajimi i modeleve të përditësuara të KShP-së çohen përpara së bashku me Strategjinë për Zhvillimin e Shërbimeve të KShP-së 2021-2025.

02

Përparimi i zhvillimit organizativ për operacionet efektive dhe efikase të institucioneve kryesore vartëse të MShMS-së, si Operatori i Shërbimeve Shëndetësore dhe Njësitë e tij Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Agjencia e Cilësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

03

Lëndët e geriatriisë dhe të kujdesit për të moshuarit janë përfshirë mjaftueshëm në programet ekzistuese të trajnimit pas diplomimit dhe profesionistëve të rinj u ofrohet trajnim.

04

Nxitja e rolit dhe kapaciteteve të OShC-ve dhe medias për advokim, si dhe për mbledhje dhe shpërndarje evidencash, për të përmirësuar qeverisjen dhe politikëbërjen në sistemin shëndetësor.

05

Janë zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje shëndetësore digjitale dhe cilësi e përmirësuar e kujdesit.

06

Është shtrirë gjeografikisht përdorimi i protokolleve dhe udhëzuesve klinikë për kontrollin e SJT-ve, së bashku me grupet e kolegëve.

07

Janë zbatuar dhe zgjeruar shërbimet e kujdesit në banesë.

08

Grupe specifike të popullsisë së cënueshme (pacientët që e kanë të pamundur të dalin nga shtëpia, personat e prekur nga çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit që jetojnë vetëm, viktimat e dhunës në familje...) përfitojnë nga shërbimet KShP-së në përgjithësi, dhe nga kujdesi në banesë në veçanti.

06. SHKURTESA

BNjSh	Burimet Njerëzore në Shëndetësi
DQO	Drejtoria Qendrore e Operatorit
EV	Edukimi në Vazhdim
GK	Grupi i Kolegëve
HAP	Projekti Shëndet për të Gjithë
IT	Teknologjia e Informacionit
KShP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NjKVSH	Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor
QSH	Qendër Shëndetësore
SJT	Sëmundje Jo të Transmetueshme



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Swiss TPH

Swiss Tropical and Public Health Institute

